



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Mbledhja nr. 108

Prishtinë, më 10.10.2024, në orën 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hykmete Bajrami, Arta Bajralija, Yllëza Hoti, Mirlinda Tishukaj-Sadiku, Rashit Qalaj, Hajdar Beqa dhe Albana Bytyqi.

Munguan: Halil Thaçi, Visar Korencia, Bekim Arifi dhe Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj.

Pjesëmarrësit e tjerë: Ema Krasniqi KDI, Qendresa Mulaj, ZKA. Bekim Gashi dhe Artizana Krasniqi, GP-LVV, Gent Ramosaj, GP-AAK, Valentin Beiqi GP- PDK, Munib Durguti-Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi: Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 17.9.2024 dhe 24.9.2024;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për sesionin vjeshtor 2024;
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil për vitin 2023;
5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2023;
6. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare, për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2023;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 17.9.2024 dhe 24.9.2024

Procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 17.9.2024 dhe 24.9.2024, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për sesionin vjeshtor 2024

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Staf i komisionit ka përgatitur dhe ka proceduar në komision për shqyrtim dhe miratim draft planin e punës së komisionit për sesionin vjeshtor të vitit 2024, siç kërkohet me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, që komisionet çdo sesion të përgatisin planin e vet të punës. Ky plan i punës së komisionit është përgatitur bazuar në fushëveprimin e komisionit. Plani mund të plotësohet dhe ndryshohet varësisht nga dinamika e punëve të komisionit dhe vendimet e Kryesisë së Kuvendit. Nëse keni diçka për të plotësuar. Nëse jo, e qesim në votim.

Përfundim

KMFP-ja, me votat e të gjithë deputetëve pjesëmarrës, miratoi Planin e punës së komisionit për sesionin vjeshtor 2024.

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil për vitin 2023

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Si komision kemi vendosur të shqyrtojmë disa Raporte të auditimit të agjencive të pavarura që i raportojnë Kuvendit. Raporti i auditimit për pasqyrat vjetore financiare, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil për vitin 2023, ka opinion të pamodifikuar. Ky raport ka rezultuar pa asnjë gjetje. Nëse nuk keni diçka për të shtuar për këtë raport, atëherë, na mbetet vetëm të njoftojmë komisionet funksionale, për shqyrtimin e tij.

Përfundim

KMFP-ja vendosi që raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të KPMSHC-së, për vitin 2023, të mos e adresojë për shqyrtim në seancë plenare dhe nuk ka as rekomandime për KPMSHC. Për këtë njoftohet komisioni përkatës parlamentar.

5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2023

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Ky raport po ashtu, ka opinion të pamodifikuar. Por ky raport ka rezultuar me një gjetje. Gjetja ka të bëjë me tejkalimin e afateve të parapara ligjore në funksionin e detyrës për zëvendësuesit/ushtruesit të detyrës dhe transferit të përkohshëm. Në katër raste, pozitat e rregullta mbahen me ushtrues detyre përtej afatit ligjor. Tejkalimi i këtij afati ishte kryesisht mbi dy vite. Ndërsa në tri raste, raste tjera janë transferuar përkohësisht, nëpunës (staf) për më shumë se gjashtë (6) muaj. Këto afate janë të tejkaluara bazuar në Ligjin nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. A ka dikush diçka për të shtuar, apo ta procedojmë tutje.

Hajdar Beqa: Kjo gjetje sa i kemi pa raportet, edhe për këtë institucion nuk është risi. Sepse kjo qeveri po e kalon krejt mandatin me ushtrues detyre dhe kjo tashmë është bërë rutinë për ta, që më të vërtet është shqetësuese. E pamë te pagat e shërbyesve civilë, pati vonesë pikërisht për këtë arsye se qeveria s'ka qenë vigjilente për emërimin e zyrtarëve të rregullt po i ka lënë kështu pozitat me ushtrues detyre.

Përfundim

KMFP-ja vendosi që raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të AKKVP-së, për vitin 2023, të mos e adresojë për shqyrtim në seancë plenare dhe nuk ka as rekomandime për AKKVP. Për këtë njoftohet komisioni përkatës parlamentar.

6. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare, për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2023

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Edhe Raporti i auditimit për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, ka opinion të pamodifikuar. Ky raport po ashtu, ka rezultuar me një gjetje dhe ka të bëjë me Nënvlërësim të pasurive. Kemi të bëjmë me një shumë prej 10,400€ pagesa për 15 monitorë, 10 kompjuterë dhe një lloj top të cilat secila është nën vlerën 1,000€ nuk ishin regjistruar në regjistrin e-pasuria. Por, që sipas ZKA-së, menaxhmenti i KRPP-së, ka ndërmarrë veprimet e duhura duke regjistruar pasurinë më datën 6.3.2024. Nëse keni diçka për të shtuar, e thash janë agjencitë të cilat kanë buxhet kryesisht për paga. Nuk i kemi ftuar, sepse i kemi pas vitin e kaluar dhe nuk kanë as gjetje materiale.

Përfundim

KMFP-ja vendosi që raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të KRPP-së, për vitin 2023, të mos e adresojë për shqyrtim në seancë plenare dhe nuk ka as rekomandime për KRPP. Për këtë njoftohet komisioni përkatës parlamentar.

7. Të ndryshme

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Në këtë pikë, si komision na kanë mbetur disa raporte pa përfundim: Raportin e auditimit të performancës “Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit”. Deputete raportuese ka qenë Mirlinda Tishukaj- Sadiku. Kemi dy propozim-rekomandime dhe deputetja ka propozuar që ky raport të adresohet për seancë.

Mirlinda Tishukaj -Sadiku: E kemi diskutua, por ka kohë dhe nuk jam e sigurt nëse e kemi propozua për seancë. Por, unë konstatoj që këto dy rekomandime ti adresohen MKRS-së, sepse siç e keni pa edhe Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport e kanë në rend dite, mbikëqyrjen e ligjit për sponsorimin e sportit dhe besoi që edhe aty do të kyçem dhe ta jap kontributin tim, në lidhje edhe me gjetjet e ZKA-së. Po ashtu, e kam analizua edhe rregulloren e publikuar me 11.6.2024, e cila e ka adresua çdo detaj që koïncidon edhe me gjetjet e ZKA-së. Prandaj, këto dy rekomandime:

1. Të shikohet mundësia e integritetit të sistemit MKRS-ATK në lidhje me vërtetimet e sponsorizimeve dhe të kenë informata kthyesë nga federata sportive: fondet, transferi bankar drejt

organizatës sportive dhe **2.** ATK-ja të jetë më proaktive në verifikimin e vërtetimeve të lëshuara nga MKRS-ja dhe të zbatojnë dënimet konform ligjit për sponsorizim që është në fuqi.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Deputete, rekomandimi i dytë është sapo e kuptojmë ne për ATK-në, ndërsa, ju e thatë t’i shkojnë MKRS-së. Po ashtu, e kemi mundësinë edhe si deputet ti japim kontributet tona. Po ashtu, po besoi që gjatë këtij procesi ata po ashtu i kanë paraparë edhe gjetjet e ZKA-së.

Mirlinda Tishukaj- Sadiku: Po njëri rekomandim është për ATK-në. Ndërsa, sa i kam parë rekomandimet e Komisionit funksional. Nuk është që e kam parë saktë se e kanë target se ku është saktë mangësia e sistemit. Me gjithë respektin për punën e kolegëve deputetë, i kanë disa rekomandime më shumë, që kanë anua se ka diskriminim, në thonjëza, në mes të kategorive të sportit dhe kulturës, në favor të sponsorizimeve. Andaj, këto dy rekomandime do të jenë vlerë e shtuar. Sepse edhe gjetjet e ZKA-së, e adresojnë saktë se ku çalon zbatimi i këtij ligji.

Hajdar Beqa: Së paku rekomandimi i dytë, mendoj se nuk është relevant. Sepse ATK-ja i ka për obligim dhe i kryen këto çështje. Po ashtu, rekomandimi i parë, të shikohet mundësia, mendoj se nuk duhet të shikohet, por e kanë obligim t’i zbatojnë rregulloret, e jo ta shikojnë mundësinë. Andaj unë nuk i përkrahi rekomandimet e tilla.

Përfundim

KMFP-ja, nuk i pati votat e mjaftueshme për adresimin e dy propozim rekomandimeve të MKRS dhe ATK. Në votim kanë marrë pjesë vetëm 4 deputetë.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Raporti i Auditimit, për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin 2023. E kam propozuar që të adresohet në seancë, por nuk ka pas kuorum për vendimmarrje. A votojmë kush është për adresimin e këtij raporti në seancë

Përfundim

KMFP-ja, nuk i pati votat e mjaftueshme që Raporti i Auditimit, për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin 2023, të adresohet për shqyrtim në seancë plenare.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Në mbledhjen e radhës do ta kemi, në shqyrtim Raportin vjetor të Auditimit për vitin 2023. Të ftohet auditorja e përgjithshme dhe ministri i financave. Si datë, pasi po pajtohem gjithë, mbetet 18 tetori. Jemi në koordinim me koordinatoren e komisionit për çdo ndryshim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Hykmete Bajrami,

Kryetare e Komisionit